



# Buletini i Lajmeve të Sigurisë Kibernetike

Shkurt 2022

## SI TË MBROJMË ASETET, INFRASTRUKTURAT DHE IDENTITETIN TONË DIGJITAL



Ndërsa sulmi i Rusisë ndaj Ukrainës po përshkallëzohet dhe për shkak të sanksioneve që vendet e BE-së po vendosin, duhet të jemi të vetëdijshëm dhe vigjilentë për sjelljen tonë në hapësirën kibernetike.

Për të mitiguar ndikimin e sulmeve të mundshme, AKCESK ju sugjeron disa hapa për të mbrojtur asetet, infrastrukturat dhe identitetet tona dixhitale.


### Këshilla për organizatat:

- Sigurohuni se pajisjet dhe sistemet tuaja janë të përditësuara
- Validoni aksesin remote për organizatën tuaj
- Testoni procedurat e back up
- Ndërveproni me ekipin CSIRT të organizatës suaj nëse dyshoni për sulme të mundshme

### Për individët:

- Implementoni multi-factor authentication për llogaritë tuaja.
- Përditësoni pajisjet
- Mos klikoni në link të pasigurta
- Rrisni kompleksitetin e fjalëkalimeve dhe implementoni higjenën kibernetike

## DITA E INTERNETIT TË SIGURT



Dita e Internetit të Sigurt (SID) është një event i përvitshëm që synon të promovojë një përdorim të përgjegjshëm, të respektueshëm, kritik dhe krijues të teknologjive dixhitale, veçanërisht midis fëmijëve dhe të rinjve!

### KONTAKT

Rr. "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë Albania 04-22-21039

Email: [info@cesk.gov.al](mailto:info@cesk.gov.al)

Web: [www.cesk.gov.al](http://www.cesk.gov.al)



## DITA NDËRKOMBËTARE E GRAVE DHE VAJZAVE NË SHKENCË



Më 22 dhjetor 2015, Asambleja e Përgjithshme vendosi të caktojë një Ditë Ndërkombëtare Vjetore për të njohur rolin kritik që gratë dhe vajzat luajnë në shkencë dhe teknologji.

Dita Ndërkombëtare e Grave dhe Vajzave në Shkencë, e festuar më 11 Shkurt, zbatohet nga UNESCO dhe UN-Women në institucione bashkëpunuese dhe partnerë të shoqërisë civile që synojnë promovimin e grave dhe vajzave në shkencë. Kjo ditë është një mundësi për të promovuar aksesin dhe pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë në shkencë për gratë dhe vajzat.

### MBROJTJA E FËMIJËVE ONLINE #THINKCYBER

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike në marrëveshje bashkëpunimi me Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU) në kuadër të programit global të ITU-së për mbrojtjen e fëmijëve në internet ka zhvilluar video ndërgjegjësuese "Si ta mbronni fëmijën tuaj dhe të jeni të vetëdijshëm për atë që ai/a jo po akseson në internet!".



Udhezime për industrinë e mbrojtjes së fëmijëve në Internet!  
youtube.com